



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**



**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština - Municipality of Prishtina**

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**

*14-020/04-73467*, më 17 SEP 2024

Në mbështetje të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L-040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 28/15 qershor 2008), nenit 5 paragrafi 5.2. të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike si dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 – 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës, merr këtë:

**V E N D I M**

**Për caktimin e anëtarit në Komisionin Komunal të Aksionarëve për NPL "Sport Marketing" SH.A**

1. Taulant Maxharraj caktohet anëtar në Komisionin Komunal të Aksionarëve për NPL "Sport Marketing" SH.A.
2. Anëtari i cekur në pikën 1 të këtij vendimi se bashku me 2 (dy) anëtarët tjerë të cilët i emëron Kuvendi i Kryeqytetit e përbëjnë Komisionin Komunal të Aksionarëve për Ndërmarrjen Publike Lokale "Sport Marketing" SH.A.
3. Anëtari i Komisionit Komunal të Aksionarëve i caktuar me këtë Vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Kryeqytetit.
4. Veprimet e anëtarit të Komisionit Komunal të Aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin përkatës për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin përkatës për Shoqëritë Tregtare.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 14-020/04-73467 i datës 06.06.2024.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**U DORËZOHET:**

- Anëtarit të emëruar z. Taulant Maxharraj;
- Anëtarit të liruar nga detyra z. Arben Kqira;
- Qendrës për shërbime me qytetarë; dhe
- Në dosje.

**KRYETARI I KRYEQYTETIT**  
**Përparim Rama**

